

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT

Për Aktivitetin e Prokurimit:

| | |
|------------------|------------------|
| Nr1 i prokurimit | 622-25-248-1-2-1 |
| Nr i brendshëm | 622-25-005-121 |

Sa i përket tenderit për: "Furnizimi me materiale hixhieno sanitare për nevojat e Komunës së Prizrenit".

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.P." ENARD "

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Magjistralja Prizren-Suharekë

(Adresa)

Prizren

(Vendi)

20000

(Kodi postar)

044-120 393

(Numri Telefonit)

N/A

(Numri i Faks-it)

Shaqir Tarashaj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

enard2011@live.com

(Adresa elektronike)

27.03.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi për Kontratë: 23.01.2025
Data e hapjes së ofertave: 13.02.2025
Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues B58: 11.03.2025
Kërkesa për rishqyrtim me dt: 14.03.2025
Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt. 19.03.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne me dt.23.01.2025 është publikuar njoftimi për kontratë, ndërsa me dt.13.02.2025 është bërë hapja e ofertave ku kanë ofertuar gjithsejtë gjashtë operatorë ekonomik.

Me dt.11.03.2025 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin ku është rekomanduar për kontratë **OE Master Services SH.P.K.; GUARD DE CAPITAL SH.P.K., Rruga Faik Konica L-2, 20000, Prizren ne vlere totale te ofertës 67695.00 Euro**, kurse neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar duke na eliminuar me arsyetimin si në vijim

[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye : **Ju mungojnë :**

Komisioni vlerësues konstaton se çmimet e ofruare ne tender jane ne kundërshtim me çmimet e tregut.

Arsyetimi për të na eliminuar neve është arsyetim jo i drejtë, joprofesional dhe subjektiv dhe njëkohësisht nuk ka mbështetje ligjore.

Kjo arsye është shumë e përgjithësuar dhe nuk mund të shërbejë si bazë për eliminimin tonë nga aktiviteti i prokurimit edhe pse ne të gjitha çmimet i kemi ofruar të përafërta me çmimet e tregut. Autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 61 të LPP-së se pse nuk ka kërkuar sqarime fare për çmime. Nëse eventualisht është menduar se ne kemi ofruar çmime jo normalisht të ulëta atëherë AK-së është dashur të kërkojë sqarime.

Paragrafi 1 i nenit 61 të LPP-së përcakton qartë si më poshtë:

1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafën 2. të këtij neni.

Në këtë rast nuk është zbatuar kjo dispozitë e LPP-së prandaj arsyetimi për eliminim është i kundërligjshëm.

Po ashtu edhe neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik e përcakton një gjë të tillë, që duhet të kërkohen sqarime dhe që ndalohet përjashtimi automatik i ofertave që konsiderohen jo normalisht të ulëta.

Ne kemi pasur qasje në ofertë e OE të rekomanduar për kontratë dhe kemi vërejtur se ky OE është i papërgjegjshëm me arsyet si në vijim:

- Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e nenit 9.1&9.2 të FDT-së:

Kërkesa 1 Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës duhet të jetë jo ma e vogël se 140.000,00 €.

Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca, faktuara ose flete dërgesa te nënshkruara të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve te ngjashme (të gjitha furnizime t e kryera, me biznese private, duhet të dëshmojnë edhe me transaksione bankare të cilat i kanë të gjitha elementet e pagesës për destinim të caktuar).

Në lidhje me këtë kërkesë është ofruar një listë e kontratave nga anëtari i grupit Guard De Capital SHPK si në vijim:

GUARD DE CAPITAL SH.P.K

☎ 048111704

✉ guarddecapital.shpk@gmail.com

| NR. | Titulli i kontratës | Data e nënshkrimit të kontratës | Data e përfundimit të kontratës | Vlera totale e kontratës | Emri i Blerësit | E-maili i Blerësit |
|-----|--|---------------------------------|---------------------------------|--------------------------|---|--|
| 1 | Sherbimet e pastrimit dhe mirembajtjes së objekteve | 12.03.2024 | 12.05.2024 | 45,938.83 € | SPITALI I PERGJITHESHEM GJILAN | prokurimisipitalgjilan@gmail.com |
| 2 | Mirembajtja Higjienike ne Objektet e Sistemit Prokurorial te Republikes se Kosoves | 15.05.2024 | 14.11.2024 | 68,338.39 € | KESHILLI PROKURORIAL I KOSOVES | Teuta.Krasniqi@rks-psh.org |
| 3 | Sherbimet e pastrimit dhe mirembajtjes së objekteve te MFPT-se Rishpallje 1 | 02.11.2023 | 01.11.2024 | 60,480.00 € | MINISTRIA E FINANCEVE PUNEVE DHE TRANFEREVE | xhevat.simnica@rks-gov.net |
| 4 | | | | | | |
| | | | Vlera totale e kontratave | 174,757.22 € | | |



Nga kjo listë vërehet se ky OE nuk ka ofruar dëshmi për kontrata të ngjashme të fushës së furnizimeve me material hixhienik e sanitar por ka ofruar kontrata për shërbime të pastrimit dhe mirëmbajtje higjienike, prandaj nuk është plotësuar kërkesa e lartcekur e dosjes së tenderit.

Projekte të ngjashme të natyrës së kontratës nuk mund të llogariten lloji dhe natyra tjetër e kontratës por kontrata të ngjashme duhet të llogariten ato që janë brenda natyrës dhe llojit prokurimit dhe të kontratës, p.sh tek tenderi për furnizim me material hixhienik, të ngjashme mund të llogariten furnizimet e natyrës së përafërt me kontratën apo tenderin aktual.

Duke pasur parasysh këto dëshmi atëherë kuptohet se oferta e OE të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme dhe është dashur të eliminohet nga konkurrenca e jo të favorizohet duke u rekomanduar për kontratë.

Ne me dt.19.03.2025 kemi pranuar vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku e njëjta është arsyetuar se kinse kërkesa jonë për rishqyrtim është e pa bazuar, mirëpo që nuk janë dhënë fakte dhe dëshmi konkrete për një refuzim të tillë, mirëpo vetëm është përsëritur arsyeja e eliminimit.

Pra autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, vetëm e ka kopjuar arsyen e eliminimit tonë, duke mos dhënë asnjë arsyetim se përse nuk na janë kërkuar sqarime shtesë apo ndonjë arsyetim të detajuar se përse çmimet me të cilat kemi ofertuar i ka cilësuar si jo çmime të tregut.

Njëkohësisht autoriteti kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim në lidhje me pretendimet tona ankimore kundër OE të rekomanduar për kontratë.

Andaj kur kemi parasysh faktet e lartcekura kuptohet qartë se pretendimet tona ankimore janë të bazuara sepse në të kundërtën nëse një gjë e tillë nuk do të qëndronte atëherë AK-ja do ta argumentonte të kundërtën e pretendimeve tona ankimore me fakte dhe dëshmi konkrete.

Autoriteti kontraktues më mos arsyetimin e vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, përkatësisht me nenin 108/A të LPP-së paragrafi 9 ku specifikohet qartë si në vijim “9. Refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim”.

Kërkojmë nga ana e OSHP-së që të analizoj në detaje pretendimet tona ankimore, sepse siç edhe e kemi sqaruar më lartë çmimet me të cilat kemi ofertuar ne si OE janë çmime të përafërta me çmimet e tregut, mirëpo nëse ka pasur ndonjë dilemë atëherë është dashur të kërkohej sqarime shtesë konform nenit 61 të LPP-së dhe njëkohësisht OE i rekomanduar për kontratë është OE i përgjegjshëm. Këto pretendime tona kërkojmë që të analizohen në tërësi pasi që një gjë e tillë nuk është bërë nga ana e AK-së, duke u diskriminuar ne si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku gjithashtu i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*.

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që *“Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”*, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Autoriteti kontraktues ën vend se të kursejë buxhetin e Komunës po vepron në të kundërtën duke e rrezikuar që të dëmtohet buxheti në vlerë prej: **12,821.00 €**, pasi që ne kemi ofertuar me çmim prej **54,874.00 €**, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej **67,695.00 €**. Me këtë veprim të AK-së po cenohet edhe parimi i LPP-së ekonomikiteti, kurse veprimi i AK-së po bie në kundërshtim me nenin 6 të LPP-së.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e **OE N.P." ENARD"**,

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës në vlerë prej 5,000.00 €.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*